



Republika e Kosovës
Ministria e Financave
Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Publike

Buletini Makroekonomik

Nr. 11

Janar-Qershor, 2012

Prishtinë, Dhjetor 2012

PUBLIKUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE

Ndërtesa e Qeverisë, kati XIII

10,000 Prishtinë, Kosovë

Tel: ++ 381 38 200 34 331

WEBFAQJA

www.mf.rks-gov.net

e-maili

makroekonomia@mfe-ks.org

BORDI I EDITORËVE:

Arment Merovci

Albulena Bektashi

Besart Myderrizi

Berat Havolli

Semra Tyrbedari

Valmira Rexhëbeqaj

Përdorimi i të dhënave nga ky publikim lejohet vetëm me citimin e burimit
Buletini publikohet në afat gjysmëvjetor dhe çdo përmirësim do të bëhet në web-faqe

Nëntor 2012

Përmbledhja:

HYRJE	4
1. PASQYRA MAKROEKONOMIKE	5
1.1.1. LËVIZJA E ÇMIMEVE.....	6
1.1.2. ASISTENCA SOCIALE.....	8
1.1.3. PENSIONI BAZË.....	9
2. SEKTORI FISKAL	11
2.1.1. TË HYRAT BUXHETORE QEVERTARE	11
2.1.2. TË HYRAT TATIMORE NGA KUFIRI	12
2.1.3. <i>KUTIA 1</i> NDRYSHIMET NË NORMAT TATIMORE	17
2.1.4. SHPENZIMET BUXHETORE QEVERTARE	19
3. SEKTORI FINANCIAR.....	22
3.1.1. EKONOMITË FAMILJARE.....	25
3.1.2. DEPOZITAT E KORPORATAVE JO-FINANCIARE.....	26
3.1.3. STRUKTURA E KREDIVE SIPAS INDUSTRIVE DHE MATURITETIT	26
3.1.4. PROFITABILITETI	28
4. TREGTIA ME JASHTË.....	30
4.1.1. EKSPORTET DHE STRUKTURA E SAJ	31
4.1.2. DESTINACIONI.....	32
4.1.3. IMPORTET DHE STRUKTURA E SAJ	33
4.1.4. ORIGJINA	34
5. APENDIKS.....	35

HYRJE

Në Buletinin gjysmëvjetor makroekonomik paraqiten të dhënat të mbledhura nga institucionet përkatëse të cilat janë përpunuar dhe analizuar me qëllim të ofrimit të informatave kualitative mbi trendet kryesore ekonomike që karakterizojnë gjysmën e parë të vitit 2012. Për më shumë, ky dokument përmban analiza sektoriale të cilat përfshijnë edhe vitin 2011, por theks i veçantë i është dhënë krahasimit të gjysmës së parë të vitit 2012 me atë të vitit 2011.

Të dhënat aktuale dëshmojnë se Kosova ka menaxhuar të mbetet pjesërisht e ndikuar nga krizat e vazhdueshme globale, kriza të cilat fillimisht u manifestuan në tregjet financiare të përcjellura me kriza mbi menaxhimin e borxheve publike që kapluan kryesisht disa vende të eurozonës.

Edhe pse në masë të kufizuar, efektet e kësaj krize u vërejtën në rënien e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve dhe rënies së investimeve të huaja direkte. Duke pasur parasysh që diaspora kosovare gjendet kryesisht në Gjermani dhe Zvicër, vende këto që konsiderohen si mjaft të qëndrueshme si në aspektin ekonomik ashtu dhe në aftësinë e menaxhimit të borxhit, si dhe duke u bazuar në të dhënat aktuale për gjysmën e parë të vitit 2012, efektet e kësaj krize parashihet të jenë të limituara në rrjedhën e remitencave në Kosovë.

Këto zhvillime si dhe trendet e deritanishme japin indikacione që rritja ekonomike për vitin 2012 do të jetë 3.9%. Efekte pozitive në rritjen ekonomike gjatë këtij viti vlerësohet të ketë sjellur kryesisht konsumi privat dhe investimet e përgjithshme.

Edhe gjatë këtij viti, deficitin e lartë tregtar vazhdon të mbetet brengë e vazhdueshme. Si rezultat i rënies së çmimeve të metaleve në berza ndërkombëtare, eksporti i mallrave gjatë vitit 2012 shënoj një rënie të theksuar. Kjo si rezultat i diversifikimit të ulët në mallrat e eksportuara, rrjedhimisht koncentrimin të lartë të eksporteve në kategorinë e metalit bazë dhe artikujve prej metalit bazë.

Sa i përket sektorit financiar, ai ende vazhdon të mbetet stabil dhe likuid. Përkundër tronditjeve në tregun financiar botëror në vitet paraprake por edhe zhvillimeve të fundit në ekonominë e eurozonës, asetet e sektorit financiar kanë shënuar një rritje vjetore prej rreth 6 %. Sektori bankar, duke kontribuar me një peshë të madhe në rritjen e sektorit financiar, ka vazhduar me rritjen e kredihënies, ku gjatë kësaj periudhe kreditë u rritën për 9.3 %. Po ashtu, qëndrueshmëria dhe stabiliteti i sektorit bankar vërehet edhe përmes ngritjes në depozitat bankare, ku gjatë kësaj periudhe ato patën ngritje vjetore me rreth 7.7 %.

Gjatë periudhës raportuese (janar-qershor) Indeksi i Çmimit të Konsumatorit (IÇK) në mesatare shënoj ngritje prej 1.7 %, me theks të veçantë ngritje shënuan çmimet e ushqimit dhe naftës.

Buletini gjysmëvjetor makroekonomik përbëhet nga dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë trajtohen vlerësimet për zhvillimin ekonomik dhe fiskal gjatë vitit 2012, dhe pjesa e dytë paraqet analiza të sektorit financiar dhe atij të jashtëm.

1. PASQYRA MAKROEKONOMIKE

Rimëkëmbja ekonomike globale është duke vazhduar edhe përkundër paqartësive të mëdha që janë duke i përcjellur këto zhvillime. Në periudhë afatmesme, këto paqartësi kryesisht kanë të bëjnë me lëvizjet ekonomike globale në një mjedis i cili është duke u karakterizuar me borxhe publike të konsiderueshme, si dhe nëse ekonomitë në zhvillim, si shtytës të rritjes ekonomike globale, do të vazhdojnë me rritje ekonomike pa u ndikuar shumë nga lëvizjet në shtetet me ekonomi të avancuara.

Në vazhden e këtyre zhvillimeve, ekonomia vendore ka vazhduar ecjen e saj duke mos u ndikuar substancialisht nga këto zhvillime, megjithatë, të dhënat aktuale për vitin 2012 tregojnë një rënie të lehtë në investimet e huaja direkte dhe një rënie më e theksuar në eksportet e mallrave.

Këto zhvillimeve si dhe trendet e deritanishme japin indikacione që rritja ekonomike për vitin 2012 do të jetë 3.9%. Efekte pozitive në rritjen ekonomike gjatë këtij viti vlerësohet të kenë sjellur kryesisht konsumi privat dhe investimet e përgjithshme.

Struktura e importit në Kosovë paraqet një pasqyrë të qartë të nivelit dhe strukturës së konsumit të përgjithshëm. Nga të dhënat e deritanishme të importit vërehet një ngritje e theksuar e sasisë së importuar të mallrave konsumuese. Më konkretisht, pas rënies së ndjeshme gjatë dy muajve të parë të vitit, në muajt vijues është evidentuar një rritje prej mbi 10% e sasisë së mallrave konsumuese të importuara. Ndonëse kjo rritje mund të jetë mbështetur nga ngritja e të ardhurave nga kompensimi i punëtorëve kosovar që punojnë në vendet e Lindjes së Mesme¹, efekti i plotë i ngritjes së pagave të disa kategorive të shërbyesve civil në vitin e kaluar vlerësohet të ketë qenë i konsiderueshëm. Njëkohësisht, kësaj i ka kontribuar edhe rritja e kredive për ekonomitë familjare krahasuar me vitin 2011. Për më shumë, kjo ngritje pjesërisht mund të jetë mbështetur edhe nga rënia e lehtë e çmimit të produkteve ushqimore, gjë që mund të ketë ndikuar në rritjen e sasisë së konsumit. Një faktor shtesë që ka stimuluar konsumin si në vitin 2011 ashtu edhe gjatë vitit 2012, ka qenë edhe shpërndarja e fondeve të rezervuara për punëtorë nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, gjegjësisht 20 % i vlerës së aseteve të ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara. Bazuar në këto dhe zhvillime të tjera, rritja reale e konsumit privat për vitin 2012 parashihet të rritet me 4.7 %.

Të dhënat e deritanishme dëshmojnë faktin se struktura e mallrave të importuara në vazhdimësi po tregon një tendencë të zhvendosjes drejt mallrave që përdoren si lëndë e parë e prodhimit si dhe drejt mallrave që përdoren për investime. Kjo konfirmon edhe faktin e rritjes së vazhdueshme të investimeve në Kosovë gjë që pritet të përmirësoj edhe nivelin e zëvendësimit të mallrave të importuara me ato vendore.

Rrjedhimisht, bazuar në të dhënat e importit dhe strukturën e tij, gjatë periudhës janar- qershor 2012 vërehet një rritje prej 6.3 % e sasisë së importit të mallrave investuese në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar. Ngritja e investimeve private kryesisht ka ardhur si rezultat i përmirësimit të vazhdueshëm të parakushteve për zhvillim të biznesit të shoqëruar me politika të favorshme tatimore. Po ashtu, në rritjen e investimeve gjatë këtij viti, ndikim të ndjeshëm ka pasur edhe rënia e çmimeve të importit të mallrave

¹ Bazuar në të dhënat aktuale të BQK-së, të hyrat nga kompensimi i punëtorëve për gjysmën e parë të vitit 2012 kanë shënuar ngritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

ndërtimore, e që vije si rezultat i rënies së çmimit të metaleve. Andaj, bazuar në këto zhvillime, në fund të vitit 2012 investimet e përgjithshme parashihen të rriten me 8.0 % në norma reale.

Kontribut të rëndësishëm në rritjen e investimeve të përgjithshme edhe këtë vit kanë pasur investimet publike. Këto investime kryesisht ndërlidhen me projekte të rëndësishme infrastrukturore të cilat pritet të vazhdojnë edhe përgjatë periudhës vijuese.

Rritjen ekonomike gjatë vitit 2012 e ka ngadalësuar në masë të konsiderueshme rënia e eksportit të mallrave dhe rënia e Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Kjo rënie kryesisht i atribuohet rënies së çmimit ndërkombëtar të metaleve, gjë që ka ndikuar edhe në rënien e eksportit të metaleve, produkte këto të cilat përbejnë rreth 60 % të eksportit kosovar të mallrave. Ndonëse bazuar në të dhënat e fundit, sasia e eksportuar e mallrave ka shënuar rënie prej mbi 20 %, vlerësohet se përveç metaleve, eksporti i produkteve tjera ka shënuar rritje të konsiderueshme dhe për shkak të bazës së ulët rritja e eksportit të këtyre produkteve vetëm pjesërisht ka arritur të kompensoj rënien e eksportit të metaleve. Si rrjedhim, eksporti i mallrave parashihet të shënoj një rënie reale prej rreth 22 % në mesatare përgjatë vitit 2012.

Kriza e eurozonës ka shfaqur efektet e saja kryesisht në sektorin e shërbimeve. Duke pasur parasysh që eksporti i shërbimeve të udhëtimit është shtytësi kryesor i eksportit të përgjithshëm të shërbimeve, rënia në këtë komponentë, që vlerësohet të ketë ardhur si pasojë e numrit më të vogël të vizitave nga ana e diasporës, ka ndikuar edhe në rënien e eksportit të shërbimeve në përgjithësi. Edhe pse të dhënat për gjysmëvjetorin e parë të vitit dëshmojnë për një rënie prej 16 % të eksportit të shërbimeve, të dhënat për konsumin dëshmojnë për një fluks më të madh të diasporës kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht. Andaj, deri në fund të vitit 2012, eksporti i shërbimeve parashihet të bie me rreth 6.9 %. Ndërsa, ngadalësimi i rritjes ekonomike në vend pritet të ndikoj edhe në rënien e importit të shërbimeve dhe si rrjedhim, për vitin 2012 importi i shërbimeve parashihet të bie me 2.6 %.

1.1.1. LËVIZJA E ÇMIMEVE

Për dallim nga viti 2011 ku lëvizjet e çmimeve të përgjithshme ishin më të theksuara, gjysmëvjetori i parë i vitit 2012 u karakterizua me një stabilizim të çmimeve. Gjatë periudhës raportuese, niveli mesatar i çmimeve të përgjithshme të matur nga Indeksi i Çmimit të Konsumatorit (IÇK) shënoj ngritje prej 1.7 % për dallim nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar kur ky nivel ishte rreth 9.5 % në mesatare.


Duke pas parasysh që pesha e produkteve të ushqimit në shportën e konsumatorit është e konsiderueshme, lëvizjet e çmimeve të këtyre të mirave kanë ndikim substancial në nivelin e përgjithshëm të inflacionit vendorë. Rrjedhimisht, si rezultat i kushteve të pafavorshme klimatike në disa prej shteteve që cilësohen si eksportueset më të mëdha të grurit (Rusia, Kanada, Australia), ndalimin e eksportit të grurit nga ana e Rusisë si dhe rritja e vazhdueshme e kërkesës në përdorimin e zgjeruar të produkteve bujqësore për prodhim të biodizelit, çmimet e ushqimit patën ngritje të theksuar gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit 2011. Ashtu siç ishte pritur, gjatë pjesës së dytë të vitit 2011 çmimet e ushqimit filluan gradualisht të stabilizohen për të vazhduar me të njëjtin trend gjatë pjesës së parë të vitit 2012.

Më specifikisht, çmimet e ushqimit në Kosovë gjatë periudhës janar – qershor 2012 shënuan rënie prej -1.8 % në mesatare, krahasuar me 18 % ngritje vjetore që u shënuan për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në kuadër të çmimeve të ushqimit përgjatë vitit 2011, ngritje e theksuar u shënuan në çmimet e bukës dhe drithërave (44.8 %) krahasuar me rënie prej -9.3 % sa shënuan gjatë periudhës gjashtë mujore të parë të vitit 2012. Për dallim nga gjysmëvjetori i parë i vitit 2011, gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2012 rënie u shënuan në çmimet e produkteve të vajit dhe sheqerit (-4.5 %).

Për më shumë, çmimet e naftës vazhdojnë të kenë ndikim të konsiderueshëm në determinimin e çmimeve të përgjithshme. Për dallim nga gjysmëvjetori i parë i vitit 2011, ku çmimet e naftës dhe benzinës shënuan një ngritje të theksuar si rezultat i zhvillimeve politike në lindjen e mesme, gjatë periudhës raportuese (janar – qershor 2012), ngritja e këtyre çmimeve u ngadalësua. Në mesatare gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012 çmimet e derivateve në mesatare u ngritën për rreth 8.4 %, përderisa 44.8 % ishte ngritja gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

Në figurën e mëposhtme, me qëllim të eliminimit të faktorëve të jashtëm në nivelin e çmimit vendor, grafikisht janë të paraqitura Indeksi i Çmimit të Konsumatorit përjashtuar çmimet e ushqimit si dhe IÇK përjashtuar çmimet e ushqimit dhe të naftës.

Figura 1.1: Indeksi i Çmimit të Konsumatorit, ndryshim vjetor në përqindje



Burimi: Agjencia e Statistikës së Kosovës dhe kalkulimet e departamentit të makroekonomisë

Vërehet se në pjesën e parë të vitit 2011 IÇK-ja e përgjithshme pati ngritje të theksuar si rezultat i ngritjes së çmimeve të ushqimit dhe të naftës në tregjet ndërkombëtare. Përderisa, në gjysmën e parë të vitit 2012 IÇK-ja shënoj rënie në raport me vitin paraprak, si rezultat i rënies së çmimeve të naftës dhe ushqimit. Për më shumë, gjatë kësaj periudhe, çmimet vendore përjashtuar produktet e naftës dhe ushqimit patën ngritje në tremujorin e dytë të vitit 2012 për të treguar më pastaj një tendencë rënieje.

Duke qenë se në përgjithësi ky indikator në shtete tjera tregon për nivelin e brendshëm të inflacionit, në rastin e Kosovës nuk mund të konkludohet një gjë e tillë, sepse në rastin e Kosovës produktet si rryma, mobilitet, furnizimet e ndryshme për shtëpi, por edhe ushqimet e servuara në hotele dhe restorante kryesisht janë produkte të importit. Andaj çmimet e importit kanë ndikim edhe në çmimet që do të duhej të jenë të ndikuara nga faktorë të brendshëm, që kanë të bëjnë me konkurrueshmëri dhe produktivitet.


MIRËQENIA SOCIALE

1.1.2. ASISTENCA SOCIALE

Duke qenë se Kosova vlerësohet të jetë një ndër shtetet më të varfra në rajon, me një shkallë të theksuar të varfërisë, skema e asistencës sociale e menaxhuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) gjegjësisht nga Departamenti i asistencës sociale së bashku me të hyrat nga remitencat shërbejnë si e hyrë e rëndësishme për familjet të cilat vlerësohen se jetojnë në gjendje të rëndë ekonomike. Edhe përkundër zbutjes së nivelit të varfërisë, varfëria edhe më tej mbetet shqetësim serioz i shoqërisë/ekonomisë kosovare.

Bazuar në të dhënat e publikuara nga MPMS-ja, raportohen se në fund të muajit qershor të vitit 2012 u regjistruan rreth 1,813 familje përfituese të skemës sociale më pak se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Përmbajtja e kësaj asistence sociale për familjet në nevojë ndryshon varësisht nga numri i anëtarëve që ajo familje ka si dhe kriterëve të caktuar me ligjin në fuqi. Megjithatë, siç mund të shihet nga grafiku i mëposhtëm, muaji qershor i vitit 2012 shënoj numrin më të ulët të familjeve përfituese përgjatë tri viteve të kaluara. Nëse shohim periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, vërejmë se numri i familjeve përfituese ishte më i ulët për rreth 1183 familje. Kjo rënie në familjet përfituese mund ti atribuohet filtrimit më adekuat të listave të përfituesve potencial. Për më shumë, vlera totale e ndihmesës sociale për muajin qershor të vitit 2012 kapi shifrën prej rreth € 2.2 milionë, shifër e cila është më e ulët për rreth 8.2 % në raport me shpenzimet për asistencë sociale në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Grafiku 1.2: Numri i familjeve përfituese dhe pagesat e ndihmës sociale




Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

1.1.3. PENSIONI BAZË

Pensioni bazë është përcaktuar si përfitimi mujor fiks që i ofrohet të gjithë qytetarëve të Kosovës me moshë mbi 65 vjeç. Vlera e këtij pensioni nga janari 2009 u rrit në € 45 nga € 40 sa ishte më herët. Duke filluar nga muaji mars 2008, Qeveria e Kosovës, aprovoi udhëzimin administrativ me të cilin mundësohet pagesa mujore shtesë, për të gjithë ata persona që kanë kontribuar së paku 15 vjet në sistemin e vjetër të pensioneve. Kjo vlerë shtesë u përcaktua të jetë € 35 mbi pensionin bazë, duke rezultuar në vlerë totale prej € 80 në muaj. Grafiku i më poshtëm pasqyron, numrin e përfituesve nga të dy skemat si dhe pagesat mujore përkatëse.

Nga grafiku mund të shihet se numri i përfituesve të pensionit bazë në fund të periudhës raportuese shënoj 108,187 persona, pagesa e të cilëve kap shifrën prej rreth € 5.2 milionë.


Grafiku 1.3: Numri dhe pagesat e pensionit bazë



Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Përderisa numri i kontribut-paguesve gjatë muajit qershor 2012 ishte 33,369 pagesat e të cilëve kapin shifrën prej rreth € 2.7 milionë.

Grafiku 1.4: Numri dhe pagesat e pensionit kontribut-pagues



Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

2. SEKTORI FISKAL

Në terma ekonomik, politikat fiskale janë mjet që shfrytëzojnë të hyrat qeveritare (mbledhja e taksave) dhe shpenzimet qeveritare me qëllim të sigurimit të barazisë dhe influencimin në parametrat makroekonomik. Si e tillë, politika fiskale mbetet i vetmi mjet që ka në dispozicion Qeveria e Kosovës, në mungesë të politikave monetare, për të siguruar stabilitet makro-fiskal në vend. Rrjedhimisht, shfrytëzimi i kujdesshëm i këtij instrumenti ekonomik, mbetet një prej prioriteteve me rëndësi të veçantë për politikëbërësit.


Duke qenë se politika fiskale është i vetmi instrument i politikave ekonomike në Kosovë, Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Financave ka ruajtur vazhdimisht një sistem të thjeshtë tatimor me qëllim të zgjerimit të bazës tatimore si dhe të siguroj përkrahje për sektorin privat. Vlen të ceket, se normat tatimore në Kosovë konsiderohen si më të ulëtat në rajon dhe më gjerë.

2.1.1. TË HYRAT BUXHETORE QEVERTARE

Realizimi i të hyrave të përgjithshme buxhetore, përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012 ishte më i ngadalshëm në raport me planifikimet buxhetore. Ky ngadalësim erdhi si rezultat i disa faktorëve që vlerësohen si kalimtar, prej të cilëve kushtet klimatike ishin faktori kryesor. Duke pas parasysh se të hyrat indirekte janë kontribuuesit kryesor në të hyrat totale, përkeqësimet në kushtet klimatike, që ishin prezent gjatë tremujorit të parë të vitit 2012, patën ndikim të konsiderueshëm në uljen e vëllimit të mallrave të importuara, rrjedhimisht të hyrave nga taksat doganore. Megjithatë, pritet se gjatë periudhës së mbetur, të hyrat e përgjithshme buxhetore do të rikuperohen për të arritur planifikimet buxhetore.

Më saktësisht, në fund të periudhës raportuese, të hyrat e përgjithshme shënuan rreth € 650 milionë, shifër e cila prezanton një ngritje në të hyra prej rreth 12 % në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar. Njëkohësisht, kjo shifër përfaqëson realizim të planit vjetor prej rreth 41 %. Në grafikun e mëposhtëm janë prezantuar klasifikimet e të hyrave tatimore dhe jo-tatimore si kontribuues në gjithsej të hyrat për periudhën gjashtëmujore të vitit 2011 dhe vitit 2012. Duke mos ndryshuar nga vitet paraprake, të hyrat nga tatimet kufitare vazhdojnë të jenë kontribuuesi kryesor në të hyrat e përgjithshme. Deri në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit 2012 këto të hyra kontribuuan me rreth 54.5 % në të hyrat e përgjithshme, për dallim nga 60.1 % sa ishte gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar; pasuar nga të hyrat nga tatimet vendore, kontributi i së cilave shënoj rreth 21 %. Kontribut të moderuar edhe gjatë këtij gjashtëmujori vazhdojnë të japin të hyrat jo tatimore, ku këto të hyra përfaqësuan rreth 4.1 % të të hyrave të përgjithshme. Përderisa të hyrat vetanake komunale gjatë kësaj periudhe përfaqësuan rreth 3 % të të hyrave të përgjithshme.

Grafiku 2.1: Pjesëmarrja e tatimeve në gjithsej të hyrat, në %



Burimi: Departamenti i Thesarit

Për më shumë, në vijim janë paraqitur klasifikimi i të hyrave si përqindje në Bruto Prodhimin Vendor për vitin 2011, planifikimet për vitin 2012 si dhe parashikimet për vitin 2013. Siç mund të shihet, pjesëmarrja e këtyre të hyrave në BPV nuk patë ndryshim të theksuar nga viti 2011 në vitin 2012 dhe parashikimet për vitin 2013 nuk tregojnë ndryshim substancial në burimin e të hyrave. Shohim se të hyrat e përgjithshme në raport me BPV në mesatare për vitet 2011-2013 pritet të jenë në nivel prej 27 %, 17 % të hyrat nga Dogana dhe rreth 5.6 % të hyrat nga tatimet vendore.

Tabela 2, Të Hyrat si % e BPV-së, sipas kategorive

Përshkrimi	2011	2012	2013 Proj.
Te hyrat e përgjithshme	27.4%	27.2%	26.2%
Te hyrat tatimore	22%	22%	22%
<i>Të hyrat doganore</i>	17.3%	17.2%	16.9%
<i>Të hyrat vendore</i>	5.5%	5.7%	5.5%
Te hyrat jo-tatimore dhe të hyrat vetanake	3.4%	3.3%	3.8%
BPV (në miliona Euro)	4776	5094	5429

Burimi: Departamenti i Thesarit dhe kalkulimet e Njësisë së Makroekonomisë

2.1.2. TË HYRAT TATIMORE NGA KUFIRI


Të hyrat nga tatimet doganore, apo të hyrat nga kufiri, prezantojnë burimin kryesor të të hyrave të përgjithshme buxhetore. Siç është paraqitur në grafikun më lart, këto të hyra përbëjnë rreth 55 % të gjithsej të hyrave, ndërsa nëse shikojmë raportin në mes Bruto Prodhimit Vendor, shohim se pjesëmarrja e këtyre të hyrave është në nivel prej rreth 17 % në mesatare gjatë vitit 2011 dhe 2012. Në tabelën e mësipërme është paraqitur pjesëmarrja e të hyrave si përqindje e BPV-së për vitin 2011, 2012 dhe projeksionet për vitin 2013. Shohim se pjesëmarrja e të hyrave vendore është relativisht e ulët, në mesatare rreth 5.6 %, përderisa pjesëmarrja e të hyrave jo-tatimore dhe të hyrave vetanake në BPV është në nivel prej rreth 4 %.

Në buxhetin e konsoliduar të Kosovës në fund të periudhës gjysmëvjetore të vitit 2012 gjithsej të hyra nga taksat u mblodhën rreth €470.5 milion, shifër kjo që përfaqëson një ngritje të moderuar vjetore prej rreth 1.6% në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo ngritje e ngadalësuar erdh si rezultat i rënies së të hyrave të mbledhura në kufi si rezultat i ngadalësimit në mallrat e importuara në tremujorin e parë të vitit. Përderisa të hyrat e mbledhura në vend, në fund të periudhës raportuese shënuan rreth €135 milion, duke prezantuar një ngritje vjetore prej rreth 11%.

Të hyrat nga **'Taksa doganore'** përgjatë këtij gjashtëmujori vazhdojnë të kenë trend ngritës edhe përkundër kushteve mjaft të pafavorshme klimatike që ndikuan në rënien e mallrave të importuara përgjatë tremujorit të parë të vitit 2012. Nga të dhënat e ofruara nga Doganat e Kosovës shohim se nga kjo kategori e të hyrave në fund të muajit qershor të vitit 2012 u grumbulluan rreth € 51.4 milionë. Shifër e cila përfaqëson një rritje prej rreth 1.5% në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Kjo ngritje e kësaj kategorie të të hyrave i atribuohet kryesisht ngritjes së importeve, si në volum ashtu edhe në vlerë (rezultuar nga ngritja e çmimeve të komoditeteve të cilat në rastin e Kosovës përbëjnë përqindje mjaft të lartë në import). Në grafikun e më poshtëm janë të paraqitura të hyrat nga kjo kategori për gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 dhe 2011. Siç mund të shihet, gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 të hyrat nga kjo kategori ishin më të larta se sa në tremujorin e parë të vitit 2012. Kjo rënie në të hyrat nga Taksat doganore erdhi si rezultat i kushteve atmosferike të rënda, kushte të cilat ngadalësuan qarkullimin rrugor, rrjedhimisht importin e mallrave. Megjithatë, tremujori i dytë i vitit 2012 tregoj përmirësim të ndjeshëm në raport me vitin paraprak. Duhet cekur që lëvizjet në këtë kategori ndryshojnë krahas lëvizjeve në volumin e importit të komoditeteve dhe lëvizjes së çmimit të tyre në tregun ndërkombëtarë.

Grafiku 2.2: Të hyrat nga tatimet doganore, 2011 - 2012




Burimi: Shërbimi doganor i Kosovës

Të hyrat nga **'Taksa e akcizës'** që grumbullohet në kufi kanë vazhduar me trend rritës edhe gjatë kësaj pjese të vitit 2012. Për më shumë, të hyrat nga kjo taksë kanë arritur vlerën prej rreth € 116 milionë e që korrespondon

me një ngritje prej 43 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2011. Përpos ngritjes së volumit të importit për kategorinë e mallrave që i nënshtrohen taksës në akcizë, kjo ngritje vije edhe nga ngritja e akcizës për disa produkte e në veçanti ngritjen e akcizës në duhan. Gjithashtu, nga Korriku i vitit 2011 u ndryshua akciza në vetura, masë e cila mundësoj importin e veturave të vjetëra deri në 13 vjet si dhe implementimi i akcizës në lojërat e fatit. Këto masa si dhe shtimi i importit të produkteve që i nënshtrohen taksës në akcizë, ishin faktorët që ndikuan në këtë rritje. Vlen të theksohet se akciza është një taksë e cila aplikohet në produkte të caktuara që konsiderohen produkte luksoze dhe vlera e aplikuar e saj në këto produkte është relativisht e lartë. Po ashtu, kjo taksë është specifike që nënkupton se grumbullimi i saj varet nga volumi i importit të produkteve në të cilat aplikohet kjo taksë dhe nuk ka ndonjë ndërlidhuri me lëvizjen e çmimeve.


Grafiku 2.3: Të hyrat nga akciza në kufi, në milion euro (2011 - 2012)



Burimi: Shërbimi doganor i Kosovës

Njëloj sikurse të hyrat nga taksat doganore, **‘TVSH e mbledhur në kufi’**, pas një rënie përgjatë tremujorit të parë të vitit 2012 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjatë tremujorit të dytë, si rezultat i shtimit të importeve të mallrave, shënoj ngritje. Në fund të muajit qershor të vitit 2012, këto të hyra shënuan € 180.4 milionë, për të regjistruar një ngritje vjetore prej rreth 0.6 %.


Grafiku 2.4: Të hyrat nga TVSH në kufi, në milion euro (2011 - 2012)



Burimi: Shërbimi doganor i Kosovës

Të hyrat nga **'TVSH të mbledhur në vend'** kanë vazhduar trendin ngritës përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, në përjashtim të muajit janar ku u vërejt një rënie e lehtë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Këto të hyra në fund të periudhës raportuese shënuan € 63.6 milionë, duke prezantuar një rritje vjetore prej rreth 18 % në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar. Kjo ngritje në të hyrat e mbledhura në vend është një indikator i rëndësishëm që tregon për zgjerimin e aktivitetit ekonomik në vend (rritje ekonomike), e cila reflekton ngritjen e konsumit si kontribuues kryesor në rritjen e Bruto Prodhimit Vendor.


Grafiku 2.5: Të hyrat nga TVSH vendore, në milion euro (2011 - 2012)



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

'Tatimi në të ardhura personale' paraqet një kategori të rëndësishme duke pasur parasysh që struktura e tregut të punës në Kosovë përbëhet nga një fuqi punëtore relativisht e re. Kjo kategori e tatimit përfshinë të hyrat nga pagat dhe të hyrat tjera që mund të vijnë nga aktivitete të ndryshme biznesore. Të hyrat në të ardhura personale për periudhën në vërtetim kanë performuar relativisht mirë duke arritur vlerën prej € 26 milionë apo një ngritje prej 8.3 % krahasuar me gjysmëvjetorin e parë të vitit 2011.


Grafiku 2.6: Të hyrat nga tatimi në të ardhurat personale, në milion euro (2011 - 2012)



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Nga **'Tatimet në të hyrat e korporatave'**, në fund të muajit qershor të vitit 2012 nga ATK-ja u mbledhën rreth € 30.1 milionë, shifër e cila përfaqëson një rritje prej rreth 5.2 % në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Grafiku 2.7: Të hyrat nga tatimi në të ardhurat e korporatave, në milion euro (2011 - 2012)



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

2.1.3. KUTIA 1 NDRYSHIMET NË NORMAT TATIMORE

Gjatë vitit 2012 në Ministrinë e Financave (MF) është punuar drejt rishikimit të politikave fiskale në mënyrë që të ofrohet një ambient sa më i favorshëm për bizneset dhe qytetarët në përgjithësi. Me qëllim të informimit adekuat të publikut, në vijim është përpiluar një përmbledhje e shkurtër e të gjitha ndryshimeve fiskale gjatë kësaj periudhe.

Tatimi në Vlerën e Shtuar

Duke pasur parasysh ngritjen e mirëqenies së qytetarëve, MF-ja ka propozuar ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Me këtë ndryshim, i cili ka hyrë në fuqi nga 1 korriku 2012, janë liruar nga pagesa e TVSH-së shërbimet spitalore, kujdesi mjekësor, universitetet private, mediat elektronike si dhe ato të shkruara.

Gjithashtu, me synimin e ofrimit të lehtësirave të shumta tatimore të cilat parashikohet të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendit, Kuvendit i Kosovës ka miratuar zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga pagesa e TVSH-së nga 01 janar, 2013 deri më 31 dhjetor, 2014 për importet dhe furnizimin e mallrave siç janë:

- Një mori lëndësh të para dhe makineri bujqësore të cilat janë të listuara në Aneksin IV të Ligjit mbi TVSH-në si dhe sistemi i ujitjes së tokave bujqësore;
- Furnizimi i mallrave ose shërbimeve të financuara nga parat e granteve të donatorëve në mbështetje të projekteve humanitare, rindërtuese dhe integritimeve evropiane;
- Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të bëra për Kombet e Bashkuara, Bankën Botërore dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare.

Tatimi i normës së akcizës

Me qëllim që të kontribuohet drejt mbrojtjes së ambientit, përmirësimit të sigurisë në komunikacion, si dhe rritjes së efikasitetit në përdorimin e energjisë elektrike, MF-ja ka propozuar që të aplikohet norma e akcizës në qese (3.00 euro për kg), poqa të thjeshta elektrike (0.3 euro për copë) dhe goma të vjetra (5.00 euro për copë). Ky propozim ka hyrë në fuqi nga data 1 qershor, 2012 me Vendimin nr. 07/75 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, është bërë edhe rishikimi dhe ndryshimi i Ligjit për akcizën në duhan sipas të cilit është rregulluar mënyra e pagesës së tatimit të akcizës në produkte të duhanit të prodhuar, importuar dhe shitur në territorin e Republikës së Kosovës. Tani me ligjin e ri momenti i inkasimit të tatimit të akcizës do të jetë në momentin e doganimit të mallit për importuesit, ndërsa për prodhuesit në momentin e nxjerrjes në treg. Kjo mënyrë e inkasimit do të jetë një lehtësim i madh për bizneset pasi që do të kenë mundësinë të punojnë me mjete financiare të cilat kanë qenë të shtyra që në emër të tatimit të akcizës të paguajnë para se ta posedojnë mallin.

Tatimi në të ardhura

Në mënyrë që të inkurajohen ndërmarrjet e vogla për të kaluar nga tatimi i paragjykuar në sistemin standard të tatimeve, MF –ja ka propozuar ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale dhe atë të korporatave. Ky ndryshim i cili hyri në fuqi në qershor 2012 bënë rritjen e normës tatimore nga 5 % në 9 % për veprimtaritë afariste me të ardhura bruto vjetore deri në pesëdhjetë mijë (50.000) euro të cilat merrem me veprimtaritë profesionale, të shërbimeve, zanatit, argëtimit, dhe të ngjashme.

Tatimi Doganor

Ministria e Financave (MF) ka hartuar Projektligji për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor me synimin që të zgjerohet lista aktuale e mallrave të cilat aktualisht janë të liruara përmes Rregullores së UNMIK-ut 20017/31. Përmes këtij projektligji tentohet të krijohet një ambient më i favorshëm për zhvillim të biznesit, duke ofruar lirime doganore për mallrat që shfrytëzohen si lëndë e parë, gjysmë produkte, ambalazh, makineri të cilat shërbejnë për prodhim duke përfshirë këtu edhe linjat e prodhimit. Përveç asaj, për ngritjen e mirëqenies së qytetarëve është bërë edhe lirimi doganor i disa kategorive të barnave esenciale. Përmes këtyre lirimeve doganore ulët kostoja e prodhimit vendor, stimulohet ngritja e investimeve private vendore dhe të huaja, si dhe ngritet konkurrueshmëria në mes tyre.

Ndryshimet dhe të arriturat tjera

MF-ja në kuadër të reformave fiskale gjatë vitit 2012 ka ndërmarrë një sërë masash në drejtim të krijimit të lehtësirave dhe mbështetjes së bizneseve nëpërmjet thjeshtimit të procedurave në Administratën Tatimore dhe Doganë, ku nga nëntë dokumente të cilat janë kërkuar për zhdoganim të mallit tani kërkohen katër dokumente. Në të njëjtën kohë edhe kundërvajtjet doganore janë ulur nga 5,000 euro sa ishte minimumi në 500 euro.

Gjithashtu, në prill 2012 është miratuar nga Kuvendi Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat me të cilin inicohet themelimi i Divizionit fiskal që do të veprojë në kuadër të Departamentit për çështje administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Ky Divizion do të fillojë veprimtarinë e vet nga 1 dhjetori 2012 dhe në të do të shërbejnë gjyqtarë të cilët janë trajnuar për aplikim të legjislacionit doganor dhe tatimorë gjatë procedurave ankimore kundër vendimeve të organeve tatimore. Me themelimin e Divizionit fiskal do të shkurtohen pritjet e biznesit për t'i zgjidhur ankesat nga tri vite sa është tani në dy muaj, gjë që paraqet përfitim të madh për biznesin.

Në anën tjetër, MF-ja ka propozuar aplikimin e taksës ekologjike në automjete me qëllim të mbrojtjes së ambientit nga lirimi i gazrave të dëmshme sikurse dyoksid karboni. Me Ligjin nr. 04/L-117 për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve, të gjithë personat fizikë dhe juridikë që përdorin automjete rrugore dhe automjetet e tyre ndihmëse në territorin e Republikës së Kosovës janë të detyruar të paguajnë taksë vjetore ekologjike prej 10 euro nëse pesha e automjetit është mbi 3,5 t dhe 30 euro nëse pesha është mbi 3,5 t. Kësaj takse gjithashtu prite ti nënshtrohen edhe automjetet e huaja të cilat hyjnë në Republikën e Kosovës.

Përveç këtyre të arriturave më 10 shtator, 2012 është bërë edhe nënshkrimi i marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Turqisë për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimet mbi


të ardhurat, gjë që do të ndikoj në forcimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve tregtare në mes dy shteteve. Përveç kësaj marrëveshje deri tani janë nënshkruar edhe shumë të tjera sikurse ajo me Maqedoninë, Shqipërinë, Belgjikën, Francën, Gjermaninë, Mbretërinë e Bashkuar, Austrinë, dhe Holandën.

2.1.4. SHPENZIMET BUXHETORE QEVERTARE

Shpenzimet e planifikuara buxhetore për vitin 2012 janë të aprovuara në nivel prej rreth € 1.5 miliardë. Kjo shifër njëherazi prezanton ngritje vjetore në shpenzimet qeveritare prej rreth 9.3 %. Kjo ngritje e shpenzimeve ka qenë kryesisht e ndikuar nga ngritja e pagave të kategorive të caktuara të shërbyesve civil, ngritja e lehtë e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, ngritja e subvencioneve, në veçanti për kategoritë e dala nga lufta si dhe ngritja e theksuar e investimeve kapitale të Qeverisë, që kryesisht ka të bëjë me projektin e madh të ndërtimit të autostradës Merdarë-Morinë. Si rrjedhojë, edhe përkundër ngritjes së shpenzimeve, bilanci bankar vazhdon të ruhet në nivel të mjaftueshëm ku në fund të vitit 2012 planifikohet që bilanci bankar të ruhet në nivel prej rreth 4 % të BPV.

Në grafikun e mposhtëm janë paraqitur shpenzimet e përgjithshme qeveritare në baza mujore për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011 dhe të vitit 2012. Shohim se, në fund të muajit qershor shpenzimet e përgjithshme qeveritare arritën shumën prej rreth € 625 milionë, shifër që paraqet realizim prej rreth 40 % të planifikimit për shpenzimet deri në fund të vitit.

Grafiku 2.8: Shpenzimet e përgjithshme Qeveritare, në miliona euro




Burimi: Departamenti i thesarit dhe i buxhetit

Shpenzimet rrjedhëse kjo kategori e shpenzimeve përbën shpenzimet kyçe mbështetëse të operacioneve ditore të Qeverisë dhe deri në muajin qershor të vitit 2012 këto shpenzime përbëjnë rreth 41 % të shpenzimeve totale buxhetore. Si rezultat i ngritjes së pagave për shërbyesit civil, ngritjes së subvencioneve dhe transfereve, kjo kategori krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2011 është ngritur për rreth 19 %.

Pagat dhe mëditjet në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit 2012 përbëjnë rreth 27 % të shpenzimeve totale qeveritare. Shuma totale e planifikuar për vitin 2012 për kategorinë e pagave dhe mëditjeve është buxhetuar në nivel prej rreth € 410 milionë dhe deri në fund të periudhës raportuese kjo kategori u realizua në nivel prej rreth 41 %. Si rezultat i vendimit Qeveritar për ngritjen e pagave për sektor të caktuar të shërbyesve civil, rreth 14 % patë ngritje në shumën totale të shpenzuar për paga dhe mëditje. Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur shpenzimet qeveritare sipas aktiviteteve ekonomike për gjashtëmuorin e këtij viti.

Grafiku 2.9: Shpenzimet sipas aktiviteteve ekonomike, në miliona euro



Burimi: Departamenti i thesarit dhe i buxhetit

Mallrat dhe shërbimet në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shënuan rreth € 78 milionë, duke përfaqësuar rreth 12.5 % pjesëmarrje në shpenzimet totale Qeveritare. Shpenzimet në mallra dhe shërbime patë ngritje për rreth € 19 milionë në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Subvencionet dhe transferet si kategori e cila përbën rreth 18 % në shpenzimet totale për periudhën raportuese, arritën vlerën prej € 111 milionë në fund të qershorit të vitit 2012. Kjo kategori shënoj rënie prej rreth 7 % në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar e ndikuar kryesisht nga shkurtimi i subvencioneve për ndërmarrjet publike dhe në veçanti për Korporatën Energjetike të Kosovës.

Shpenzimet kapitale edhe gjatë kësaj periudhe vazhdojnë të jenë kategori e rëndësishme në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, duke pasur parasysh që kjo kategori përbën rreth 39 % të shpenzimeve deri në fund të periudhës raportuese. Përgjatë kësaj periudhe, kjo kategori arriti vlerën në rreth € 240 milionë nga € 170 milionë sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2011. Në këtë kontekst, duhet veçuar faktin që investimet në infrastrukturë të cilat janë duke u rritur në vazhdimësi kanë qenë kontributi kryesorë në rritje të kësaj kategorie gjatë vitit 2012 dhe është parashikuar të rritet edhe përgjatë viteve vijuese pasi që nevoja për përmirësim të infrastrukturës së rëndë është ende e lartë në Kosovë.

Struktura e shpenzimeve sipas funksionit tregon se edhe përgjatë gjysmës së parë të vitit 2012 shpenzimet qeveritare u përqendruan kryesisht në kategorinë e ekonomisë që kryesisht përfshinë investimet kapitale me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës së rëndë dhe stimulimit të investimeve.

3. SEKTORI FINANCIAR

Zhvillimet në tregjet financiare në eurozonë përgjatë periudhave të kaluara u karakterizuan me paqëndrueshmëri të lartë, për tu stabilizuar në fillim të vitit 2012. Megjithatë, situata filloj të përkeqësohet duke filluar nga kuartali i dytë i vitit 2012 ku tregjet financiare në eurozonë u karakterizuan me luhatje të paparashikuara të cilat kryesisht u manifestuan nga lëvizje të paqëndrueshme në kthimet në obligacione dhe në çmimet e instrumenteve tjera financiare, si mjete për financimin e nevojave buxhetore. Këto lëvizje u manifestuan si rezultat i problemeve deficitare të disa qeverive që janë pjesë e Unionit Evropian. Si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit me qeveritë e disa vendeve evropiane, në tregjet financiare u gjenerua një tension që ndikojë në ngritjen e riskut sistematik në sektorin bankar, dhe si rrjedhojë krijoi luhatje të theksuara në funksionim të tregjeve financiare.

Ndër risqet kryesore të cilat vazhdojnë të kenë efekte negative në funksionim të mirëfilltë të tregjeve financiare janë problemet e vazhdueshme të disa vendeve evropiane me menaxhimin/ reduktimin e borxheve publike të cilat në një masë të madhe janë duke ndikuar në luhatjet (ngritjet në norma të kthimit në obligacione) së bashku me përçimin e sinjaleve për tensione të vazhdueshme në tregjet e obligacioneve.

Ndër faktorët që ndikojnë në ngritje të vazhdueshme të pesimizmit në investime nga ana e investitorëve në rrethana aktuale vazhdojnë të jenë paqëndrueshmërit fiskale, dhe zhvillimet ekonomike të vendeve të caktuara evropiane. Këto vende janë duke u ballafaquar me vështirësi në implementimin e reformave strukturore, në ngritjen e konkurrueshmërisë dhe produktivitetit në nivel me vendet tjera të zhvilluara, gjë që do të ndikonte në përmirësimin e bilancit të pagesave dhe gjenerimit të ngritjes ekonomike të tyre që si rrjedhojë do të përçonte sinjalin e qëndrueshmërisë fiskale dhe ekonomike.

Zhvillimet e dobëta ekonomike gjithashtu mund të afektojnë sektorët tjerë jo-financiarë të vendeve të caktuara, e në veçanti të atyre sektorëve të cilët janë në nivel të lartë të levës financiare që ndikon në ngritjen e riskut sistematik. Të dhënat tregojnë për nivel të lartë të levës financiare dhe vështirësi në servisim të borxhit të entiteteve jo-financiare në vende të caktuara evropiane, dhe nën supozimin e vazhdimet të situatës aktuale kjo mund të bëjë bankat komerciale të vazhdojnë të ballafaqohen me ngritje të vazhdueshme të riskut kreditorë që si rrjedhojë do të shkaktonte efektin e bilancit të gjendjes, që do të rezultonte me efekte zinxhirore të krizës ndër sektorë. Si rrjedhojë e këtyre veprimeve, Banka Qendrore Evropiane (BQE) vendosi të ndërmerr veprime të politikave ekspansive duke mbajtur normën bazë të ulët në (0.75%) si dhe u angazhua në blerjen e aseteve jo-likuide nga bankat për të ndikuar në përmirësimin dhe krijimin e një ambienti më stabil për të ulur normat e interesit për financime.

Pavarësisht veprimeve që Banka Qendrore Evropiane ndërmori, institucionet financiare në eurozonë vazhdojnë të ballafaqohen me problemet e natyrës strukturore, dhe të mënyrës së financimit të kapitalit. Për një funksionim të mirëfilltë të sistemit financiar është esenciale për bankat që të vazhdojnë me procesin e ristrukturimit të kapitalit duke reduktuar nivelin e levës financiare në përbërje të kapitalit të tyre. Gjithashtu, qeveritë e zhytura në probleme të financimit deficitar duhet të përdorin përparësitë e ofruara nga veprimet e fundit të BQE-së për të bërë ndryshimet strukturore me qëllim të përmirësimit të ambientit ekonomik të tyre që do të ndikonte në uljen e kostos së financimit, dhe ngritjen e besimit të investitorëve në funksionim të


qëndrueshëm të tregjeve financiare evropiane dhe si rrjedhojë do të ndikonte në stabilitet të valutës së përbashkët, EURO, që do të ketë efekte pozitive në stimulimin e investimeve.

3.1. SEKTORI BANKAR NË KOSOVË

Zhvillimet e lartcekura në tregjet financiare në eurozonë nuk kanë pasur efekt të drejtpërdrejtë në sektorin bankarë të Kosovës i cili deri më tani ka arritur të jetë i qëndrueshëm dhe stabil. Një mundësi e tillë është krijuar pikërisht nga integrimi i kufizuar i këtij sektori me sektorin bankar në eurozonë, pavarësisht faktit që tregun vendor e mbizotërojnë bankat të cilat kryesisht kanë kapital të financuar nga investitorët ndërkombëtar.

Fakti i një integrimi të kufizuar i cili kryesisht ka qenë i drejtuar drejt investimeve të sigurta dhe normave të ulëta të interesit ka bërë që sistemi financiar në përgjithësi të jetë stabil dhe kryesisht i koncentruar në lirin e fondeve për kërkesat lokale, nga të cilat janë realizuar fitime operacionale neto relativisht të larta duke pasur për bazë strukturën ekonomike të vendit.

Figura 3.0. Asetet e huaja neto, në miliarda euro




Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Të dhënat për gjysmëvjetorin e parë 2012 tregojnë se investimet në asetet e huaja kanë pësuar një ngadalësim për dallim nga vitet paraprake dhe kjo si rrjedhojë e ngadalësimit të plasmanëve në tregjet financiare në eurozonë. Duke ju referuar të dhënave monetare, shihet që Banka Qendrore e cila përbën rreth 54 % të investimeve ka shënuar rënie në gjysmëvjetorin e parë të 2012 për dallim nga e njëjta periudhë në 2011. Gjithashtu, korporatat tjera depozituese që kryesisht përfshijnë bankat komerciale kanë shënuar rënie në 3 % për dallim nga periudha e njëjtë e vitit 2011, e pasuar nga korporata tjera financiare me 26 %, që kryesisht përfshijnë mjetet e Trustit Pensional. Ndër faktorët që mund të kenë ndikuar në ngadalësimin e plasmanëve investuese në tregjet financiare jashtë vendit janë normat e ulëta të interesit (në vendet e sigurta investuese) si dhe kostot e transaksionit. Gjithashtu, ndër faktorët kryesorë tjerë është edhe themelimi i tregut monetar qeveritar, i cili vazhdon të jetë atraktiv për institucionet financiare lokale.

3.2. ZHVILLIMET NË SEKTORIN BANKAR

Sektori bankar, sikur edhe në vitet paraprake, përgjatë gjysmëvjetorit të parë 2012 ka vazhduar të jetë stabil dhe i qëndrueshëm. Bankat komerciale të përbëra me kapital të financuar nga jashtë vazhdojnë të përbëjnë mbi 70 % të tregut financiar, e pasuar nga bankat vendore komerciale dhe institucionet tjera financiare. Gjatë periudhës raportuese, sektori bankar shënoj një ngadalësim në ngritjen e asetëve totale për dallim nga periudha e njëjtë raportuese e vitit 2011. Përderisa në gjysmëvjetorin e parë 2011 ngritja në asetet totale ishte për 11 %, kjo shifër në gjysmëvjetorin e parë të 2012-së ishte rreth 6 %. Ndër faktorët që kanë shkaktuar ngadalësim në trendin e rritjes së asetëve totale janë zhvillimet që po mbizotërojnë në tregjet financiare ndërkombëtare që ka shtyrë bankat komerciale në Kosovë të ulin nivelin e fondeve të mbajtura në bankat ndërkombëtare, si dhe të ngadalësojnë investimet në instrumente financiare jashtë vendit.

Figura 3.1. Rritja vjetore e depozitave dhe kredive, në përqindje



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Kreditë bruto vazhdojnë të mbesin financimi kryesorë i pjesës së asetëve të bankave komerciale të cilat në gjysmëvjetorin e parë shënuan një ngritje prej 9 %, nga € 1,624 miliardë në gjysmëvjetorin e parë 2011, në € 1,776 miliardë euro në gjysmë-vjetorin e këtij viti, ku korporatat jo-financiare vazhdojnë të jenë konsumuesit kryesorë të kredive me rreth 66% dhe ekonomitë familjare me 31%.

Kreditë për korporatat tjera financiare shënuan ngritje prej 5 %, nga € 1,115 m euro sa ishin në gjysmë-vjetorin e parë 2011, në € 1,172 m euro në gjysmëvjetorin e parë 2012. Për dallim nga korporatat tjera jo-financiare, kredidhënia për ekonomitë familjare shënoi rritje më të theksuar me një normë prej 13 %, nga € 482.7 m euro në € 544.7 m euro në periudhat e analizuara.

Vërehet një ngritje relativisht e lartë në investimet në ekonomitë që nuk janë brenda valutës euro, ku vetëm në gjysmëvjetorin e parë 2012 u investuan rreth € 7.6 m euro nga € 2.4 m, me një ngritje prej 208%. Po ashtu, vërehet një ngritje e investimeve në asetet fikse që lë të kuptohet se bankat janë duke rritur investimet në ngritjen dhe përmirësimin e shërbimeve financiare.


Gjithashtu, depozitat shënuan një ngritje të ngadalësuar sikurse edhe kreditë, dhe vetëm në gjysmë-vjetorin e parë 2012 kjo rritje ishte për 8 %, nga 1,957 m në (2011-Gj1) në 2,108 m euro në (2012-Gj1). Depozitat e ekonomive familjare arritën vlerën € 379.6 m euro në gjysmë-vjetorin e dytë 2012 me një ngritje prej 20 %, ndërsa depozitat e korporatave tjera jo-financiare arritën vlerën prej € 223.2 m euro që njëherazi shënon ngritjen prej 20 %.

3.3. STRUKTURA E DEPOZITAVE DHE KREDIVE

3.1.1. EKONOMITË FAMILJARE

Depozitat familjare vazhdojnë të mbesin financimi kryesor i sistemit financiare me pjesëmarrje prej 72 % në total depozita, me vlerë nominale prej € 1,579.8 m euro. Depozitat e ekonomive familjare përgjatë viteve, 2009-2011 u rritën mesatarisht 17 %, por që ky trend në gjysmëvjetorin e parë 2012 filloj të ngadalësohet duke reflektuar efektin e zhvillimeve në eurozonë. Vetëm në gjysmëvjetorin e parë 2012 ato u rritën në € 1,416 m euro nga € 1,246.6 m euro sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit 2011. Të dhënat tregojnë se një sasi e konsiderueshme e depozitave familjare janë në llogaritë me afatizim fleksibil gjë që lë të kuptohet për një përmirësim të mëtutjeshëm të shërbimeve për klientët si rrjedhojë e konkurrencës ndërmjet bankave komerciale.

Figura 3.2. Kreditë e dhëna dhe depozitat e pranura - Ekonomitë familjare, në miliona euro




Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Kreditë e ofruara për ekonomitë familjare në gjysmëvjetorin e parë 2012 arritën vlerën € 544.7 m euro nga € 482.1 m euro sa ishin në gjysmëvjetorin e parë 2011, me një rritje prej 13 %.

3.1.2. DEPOZITAT E KORPORATAVE JO-FINANCIARE

